



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 86/12
Prishtinë, më 04.12.2012, ora 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
IMBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Safete Hadergjonaj, Naser Osmani, Jelena Bontic, Albana Fetoshi, Hykmete Bajrami, Latif Gashi, Hasime Krasniq, Sali Asllanaj, Xhevdet Neziraj, Sevdije Lama dhe Duda Balje

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Saliuki – Iseini, Luljetë Krasniqi, Dashurije Canolli, dhe Albulena Gashi (praktikant)

Gjithashtu ishin të pranishëm: Rejhane Zylfijaj Ramadan Islami (GIZ),

Mbledhjen e kryesoi: Safete Hadergjonaj, Kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:

1. **Miratimi i rendit të ditës**
2. **Miratimi i Raportit me amendamentet të Komisionit për Buxhet dhe Financa për Projektligjin nr. 04/L-165 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013;**
3. **Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-169 për Ratifikimin e Marrëveshjes për themelimin e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim;**
4. **Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja konstatoi se rendi i ditës miratohet pa ndryshime.

2. Miratimi i Raportit me amendamentet të Komisionit për Buxhet dhe Financa për Projektligjin nr. 04/L-165 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013

Kryetarja theksoi se në takimet dy ditore në Pejë i kemi miratuar të amendamentet dhe na kanë mbetur disa çështje të hapura që i kemi lënë të vendosen në këtë mbledhje. Është fjala për Universitetin e Pejës, çështja e Infrakos, një amendament në Ministrinë e Administratës Publike që ka të bëjë me një projekt të aprovuar për Prokurorin e Shtetit, amendamenti i deputetit Hydajet Hyseni, një çështje të pjesa tekstuale.

Bedri Hamza theksoi se e ka një propozim që të bëhet një rregullim i brendshëm, ka të bëjë me projektin “Fillimi i punimeve në ndërtimin e objektit të ATK-Dogana në Prishtinë” që është brenda buxhetit të Ministrisë së Financave, që të kalojë në kuadër të buxhetit të Ministrisë së Administratës Publike që është përgjegjëse për ndërtimin e objekteve shtetërore dhe kanë departamentin për mbikëqyerje.

Komisioni njëzëri miratoi propozimin e Ministrisë së Financave si në vijim: Nën-Programi – Zyrat për Mbledhjen e Tatimit/Doganat, me kod 133, hiqet projekt nr. 11286 “Fillimi i punimeve në ndërtimin e objektit të ATK-Dogana në Prishtinë”, në vlerë prej 800,000 €, nga buxheti i Ministrisë së Financave dhe bartet në buxhetin e Ministrisë së Administratës Publike.

Kryetarja theksoi se në amendamentin 23 shihet se është zgjidhur çështja e ndarjeve buxhetore për financimin e Universitetit të Pejës siq kemi vendosur, kjo ka krijuar edhe amendamentin 24 që ka të bëjë me Universitetin e Prishtinës, përkatësisht me numrin e punonjësve dhe mjeteve që merren dhe barten në Universitetin e Pejës ashtu siq kemi vendosur si komision.

Hykmete Bajrami theksoi se është vendosur vitin e kaluar që për amfiteatrin e fakulteti ekonomik të UP, të ndahen 500,000 euro, por puna është në gjysmë por janë kërkuar që 200.000 euro barten për vitin tjetër ose projekti nuk do të përfundojë.

Kryetarja ne e kemi vlerësuar si një projekt të rëndësishëm por ndoshta ka pak neglizhenc të procedurave, por është mirë me gjet mënyren me i bart mjetet për vitin e ardhshëm.

Bedri Hamza ligji është shumë i qart nëse nuk shpenzohet mjetet këtë vit, nuk mund të bartet në vitin e ardhshëm, por duke vlerësuar rëndësinë e projektit, ne propozojmë të ndahen 250,000 euro në emër të projektit të amfiteatrit të fakultetit ekonomik të UP-së.

Komisioni miratoi njëzëri amendamentin që në Nën-Programin – Universiteti i Prishtinës, me kod 904, kategoria ekonomike Shpenzime Kapitale nga granti, të shtohet projekti kapital nr. 13268 “Ndërtimi i Amfiteatrit për Fakultetin Ekonomik”, në vlerë 250,000 €.

Komisioni miratoi njëzëri amendamentin 32 që në kuadër të buxhetit të Ministrisë së Administratës Publike, në nën programin - Departamenti i standardeve dhe politikave të IMNQ, me kod 123, Projekti me numër të kodit 10012, “Kompleksi i ri Qeveritar në Hajavali në afërsi të Prishtinës”, merret shuma prej 200,000 € dhe të vendoset në kuadër buxhetit të Prokurorit të Shtetit, të Programi 012 – Prokurorët dhe Administratat, shtohet projekti i ri kapital, “Ndërtimi i Objektit të Prokurorisë Themelore në Gjakovë”, në vlerë prej 400,000 €.

Kryetarja amendamenti i propozuar nga deputeti Hydajet Hyseni mund të ngjal diskutime në Kuvend, do të donim një sqarim nga Ministri i Financave lidhur me këtë.

Bedri Hamza ligji për kompensimin e ish të burgosurve ka qenë i sponzorizuar prej deputetëve, është miratuar dhe është në fuqi por ende nuk janë nxjerr aktet nënligjore për të bërë vlerësimin e kostos së tij, pasi që ligjit i ka munguar deklarata financiare. Grupi punues është duke punuar, është nxjerrur rregullorja e punës dhe janë në proces nxjerrja e akteve nënligjore dhe më pas do të konstatohet vlera ekeakte e kostos së ligjit. Në proceset e ardhshme buxhetore zbatimi i tij do të jetë pjesë e tabelave buxhetore, sikurse edhe ligji i veteranëve të luftës.

Latif Gashi jam dakort me atë që e tha Ministri se vlejn të njëjtat rregulla si për veteranët ashtu edhe për të burgosurit politik se duhet të bëhet një verifikim dhe në bazë të kriterëve të caktohet se kush e gëzon të drejtën e statusit të të burgosurit politik.

Salih Asllanaj unë parimisht jam që kur të miratohen ligjet të jenë edhe të zbatueshme, dhe në këtë rast për të burgosurit politik kisha qenë pro zbatimit të ligjit, natyrisht me mundësitë financiare që ka buxheti i Kosovës. Por mënyra si është propozuar amendamenti pa ndonjë shumë specifike, dhe justifikimi që tha ministri qëndron edhe ndoshta nga viti 2014 fillon zbatimi i këtij ligji dhe duhet të fillojë zbatimit i tij.

Kryetarja theksoi se kemi edhe një propozim të Këshillit Gjyqësor për një rregullim të brendshëm brenda programeve të kësaj organizate buxhetore.

Komisioni njëzëri miratoi që në Organizatën Buxhetore Këshillit Gjyqësor i Kosovës, në nën-programin 332 – Sektori për Integrim Gjyqësor, shuhet dhe të gjitha mjetet buxhetore dhe numri i pozitave kalojnë në Nën-programin 333 – Gjykata dhe Sekretariati.

Kryetarja e kemi lënë temë të hapaur edhe një çështje në pjesën tekstuale, përkatësisht në nenin 10, paragrafi 3 që thotë se punonjësit e Organizatave Buxhetore të Institucioneve të Pavarura që kanë pagat e tyre jashtë sistemit të pagave të Shërbyesve Civil, nuk mund të shfrytëzojnë të drejtën për shujta, kompensime të tjera dhe rritjen prej tridhjetë përqind (30%) sipas vendimit të Qeverisë. Ndërkaq ka mbetur të diskutohet çështja e kompensimeve dhe mendojë që në bazë të ligjit për shërbyes civil, përmes udhëzimeve administrative të rregullohet kjo pjesë. Në pjesën tekstuale e keni vetë paragrafin 3 që ka mbetur pa u votuar.

Komisioni njëzëri miratoi ndryshimin në nenin 10, që paragrafit të shtohet paragrafi 3, me tekstin: “Punonjësit e Organizatave Buxhetore të Institucioneve të Pavarura që kanë pagat e tyre jashtë sistemit të pagave të Shërbyesve Civil, nuk mund të shfrytëzojnë të drejtën për shujta, kompensime të tjera dhe rritjen prej tridhjetë përqind (30%) sipas vendimit të Qeverisë.”

Hasime Krasniqi e kam një kërkesë që ka të bëjë me ndërtimin e një kopshti në komunën e Malishevës e cila nuk ka fare kopsht të fëmijëve, e për të cilën kemi diskutuar edhe në takimin tonë në Pejë dhe ka mbetur të diskutohet sot dhe të votohet

Kryetarja sqaroi se kërkesat që kanë mbërrirë pas ditës së shtunë nuk mirren në konsideratë dhe për këtë çështje une nuk mundem me marr vendim.

Hasime Krasniqi kjo çështje u ngrit në takimin e fundit të komisioni dhe është folur dhe ka qenë disponimi i komisionit me shqyrtue sot dhe të lutem të qitet në votim.

Naser Osmani ne nuk kemi marrë për bazë propozimin pasi që nuk ka pasur kërkesë konkrete nga komuna. Edhe sot me i shti procedurat për projekte të reja nuk mundemi, as nuk më duket korrekte, pavarësisht për qka bëhet fjalë.

Latif Gashi kërkesën e znj. Hasime ne e kemi diskutuar në takimin e fundit të komisionit por e përkrahi edhe mendimin e kryetares dhe nënkryetarit për mungesën e kërkesës të shkruar nga komuna. Kërkesa është e arsyeshme nëse ka vullnet e votojm nëse jo le të mbetet për rishikim.

Latif Gashi sa i përket çështjes së Infrakos-it, në ministrinë e infrastrukturës edhe zhvillimit ekonomik i kanë bërë ndarjen e dy kompanive në infrakos edhe trejkos dhe kanë marrë vendim për zvogëlimin e

tarifave që janë edhe të hyrat e kompanisë. Trajkoso pa shërbimin e Infrakos-it, nuk mundet me punue edhe kërkon 1 milion e 200 mijë euro suvensione nga 1 milion 600 mijë që i ka humbje minimum. Unë kërkojë që ti ndahen mjetet, përndryshe rrezikon mbylljen.

Bedri Hamza kam drejtë të jem kritikues ndaj ministrisë së infrastruktures dhe të zhvillimit ekonomik që kanë pasur mundësinë të paraqesin kërkesat e tyre të arsyeshme brenda kufijëve agregat. Pse ministria e zhvillimit ekonomik e ka paraparë këtë projekt kaq të rëndësishëm dhe nuk e ka bërë pjesë të buxhetit të saj. Unë e kuptoj që vullnetin tuaj me modelu zgjidhjen, por të jeni të sigurt që sot po e bëjmë pjesë të buxhetit, por kemi me pas problem me heq në të ardhmen.

Latif Gashi ne e kemi aprovuar një ligj të hekurudhave me të cilin janë krijuar këto kompani që janë në kuadër të ministrisë së zhvillimit ekonomik dhe infrastrukturës. Pajtohem me ministrinë se është marrë vendim i gabuar kur janë zvogëluar tarifatat, por ne kemi dy rrugë, të ndahen mjetet apo ato do të mbylljen.

Bedri Hamza jam ti ndahet buxhet këtyre dy kompanive për një zgjidhje afatshkurte, por ministrinë përkatëse duhet të kenë të qartë që në stazat afatgjatë të mos planifikojnë buxhet për financimin e tyre. Këto janë ndërmarrje publike dhe ato duhet të jenë komercialisht të qëndrueshme në treg dhe jo të varen nga subvencionet.

Kryetarja edhe unë jam shumë e interesuar që asnjë cent mos të shkon në ndërmarrjet publike. Unë mbaj qëndrimin tim se me ndarjen e këtyre institucioneve është bërë gabim i madh me justifikimin se është kërkuar nga komisioni evropian, ne duhet kuptuar se i bëjmë gjërat hap pas hapi sepse nuk i kemi mundësitë me i bë gjërat siq kërkohet. Megjithatë është mirë me u bërë një zgjidhje për këtë rast deri në gjashtë mujorin e parë.

Hykmete Bajrami në dëgjimin buxhetor, ministria e infrastruktures nuk ka qenë në gjendje me justifikue ndarjen e hekurudhave në dy institucione dhe kjo lenë përshtypje se po krijohen institucione me akomodue njerëz. Është dashur të kemi një plan dhe një strategji çka donë qeveria me bë në 10 vitet e ardhshme me hekurudha dhe a ekzistojnë prioritetet dhe cilat kanë me qenë investimet. Kam frikë se kjo punë nuk do të jetë vetëm një zgjidhje gjashtë muajsh por ka me qenë prap problem dhe kanë me ardhur me kërkesa të njëjta.

Latif Gashi kjo çështje u politizua shumë, po nuk kërkesa individuale por mbrojtje të interesit të përgjithshëm. Ne e dimë se çdo kompani publike në fazën fillestare është përkrahur dhe mëpastaj qeveria e Kosovës ka marrur mjete.

Agim Krasnqi unë propozoj që kompania Infrakos të përkrahët me një buxhet të njëhershëm për vitin 2013 dhe propozoi ndryshimin që mund të bëhet në buxhetin e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik.

Bedri Hamza mendojë që tiu ndahen 50 % e mjeteve të kërkuara me shpresë që kjo çështje të zgjidhet dhe ndërmarrjet publike të heqen nga tabelat buxhetore.

Kryetarja pas katër muajsh do të ftojme kemi ministrin e financave, të zhvillimit ekonomik, infrastrukturës dhe dy kompanitë dhe do të bisedojmë për këtë çështje dhe të mos përballemi me një problem të tillë gjatë rivlerësimit të buxhetit.

Komisioni me një një Abstenim (Xhevdet Neziraj) dhe të gjithë të tjerët Për, miratoi ndryshimin që në kuadër të buxhetit të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, në nën-Programi KOSTT me kod 222, projekti

nr. 13582 “ Ndërtimi NS 110/10/(20) Mitrovica 2 ne linjat përcjellëse 110 kw”, shuma 1,800,000 €, të ndryshohet në shumën 1,400,000 €. Dhe në nën-programin Infrakos me kod 277, kategoria ekonomike Subvencione dhe Transfere, të shtohet shuma 600,000 €.

Hasime Krasniqi theksoi se i falënderon të gjithë anëtarët e komisionit dhe ministrinë për mbështetje morale për një projekt shumë të rëndësishëm për komunën e Malishevës, që ndikon në edukimin e fëmijëve dhe pres në rishikim të buxheti të realizohet ky projekt.

Xhevdet Neziraj ne edhe vitin e kaluar edhe këtë vit kemi shqyrtuar kërkesa individuale të deputeteve dhe disa kanë kaluar dhe është mirë që në të ardhmen të mos kemi këso kërkesa individuale, megjithatë unë jam të përkahim kërkesën e Hasime qoftë edhe me rishikim të buxhetit.

Kryetarja mendojë që është nevoja që ne si komision pas miratimi te buxheti të vendosim parime dhe kushte se si duhet bërë kërkesa, që duhet të jetë e specifikuar, kur duhet të jetë paramasa dhe parallogaria e projektit dhe jo vetëm shuma.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Komisioni me një votë Kundër (Albana Fetoshi), një Abstenim (Hykmete Bajrami) dhe nëntë Për (Safete Hadergjonaj, Naser Osmani, Jelena Bontic, Latif Gashi, Hasime Krasniq, Sali Asllanaj, Xhevdet Neziraj, Sevdije Lama dhe Duda Balje) nxori këtë

Rekomandim

Miratohen Raporti me amendamente për Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013, i cili procedohet për shqyrtim dhe miratim në procedurat e mëtutjeshme të Kuvendit.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-169 për Ratifikimin e Marrëveshjes për themelimin e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim

Kryetarja jemi të njohur që Kosova është bërë anëtarë e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe si rezultat është proceduar projektligji për ratifikimin e marrëveshjes së BERZH-it , ku edhe Qeveria merr obligimin e pagesës ne emër të anëtarësimit në këtë institucion financiar të rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të vendit.

Bedri Hamza, sqaroi se Kosova e ka marr numrin e votave për me qenë anëtare dhe janë siguruar mjetet për pagesën e kotës dhe duhet miratimi i marrëveshjes nga Kuvendi, që është një sukses për financimin e projekteve publike edhe private dhe kërkojmë përkrahjen nga Kuvendi.

Pas sqarimeve, Komisioni njëzëri nxori këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të miratojë Projektligjin për Ratifikimin e Marrëveshjes për themelimin e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim.

Mbledhja përfundoi: 11:30

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Safete Hadergjonaj